

**Njoftim për përqendrim me të cilin NOVA LJUBLJANSKA BANKA d.d., Slloveni do të fitoj kontroll mbi SLS HOLDCO, shoqëria holding d.o.o., Slloveni**

**(lënda nr. 08-182/2023)**

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ Nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 21.12.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim i përqendrimit me të cilin **NOVA LJUBLJANSKA BANKA d.d.**, me seli të vendosur në Trg Republike 2, 1000 Lubjana, Slloveni, do të fitojë kontrollin e vetëm mbi **SLS HOLDCO, shoqëria holding d.o.o.**, Lubjana me seli në Blajvajzova cesta 30, 1000 Lubjanë, Slloveni.

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit**

**NOVA LJUBLJANSKA BANKA d.d.**, (NLB) është një shoqëri aksionare dhe një nga institucionet financiare në Republikën e Sllovenisë, e cila ofron një gamë të gjerë shërbimesh bankare, duke përfshirë shërbime të tjera financiare brenda grupit, të cilat përfshijnë shërbime bankare për popullatën, shërbime bankare për sektorin e biznesit dhe shërbime të tjera. Përveç kësaj, NLB ofron shërbime të menaxhimit të fondeve dhe pensioneve, pasuri të paluajtshme, banka investuese dhe shërbime të tjera.

Grupi NLB në Maqedoni aktualisht ka 2 shoqëri të lidhura:

- NLB Bank AD Shkup me seli në rr. Vodnjanska nr. 1 Shkup, me NUAS 4664531, me aktivitet prioritar - ndërmjetësim tjetër monetar, dhe
- Shoqëria e lizingut NLB LEASE&GO SHPK Shkup me seli në rr. Vodnjanska nr. 1 Shkup me NUAS 7628838, me aktivitet prioritar Lizing financiar.

**SLS HOLDCO, shoqëria holding d.o.o** zotëron 100% të pjesëve në shoqërinë sllovene të lizingut SUMMIT LIZING SLOVENIA d.o.o., me seli në: Rruga Flajshmanova 3, 1000 Lubjanë ("**SUMMIT LIZING**"). SUMMIT LIZING zotëron gjithashtu 100% të pjesëve në shoqërinë kroate të lizingut MOBIL LIZING d.o.o., me seli në Rrugën Kovinska 5, Zagreb, Kroaci.

SUMMIT LIZING është ofruesi kryesor i financimit të makinave në Slloveni. SUMMIT LIZING është gjithashtu një ofrues kryesor i financave për konsumatorët e pikave të shitjes në Slloveni.

SUMMIT LIZING nuk ka shoqëri të lidhura në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe as nuk ka gjeneruar të ardhura në vitin 2022 në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Sipas parashtruesit të njoftimit, tregu relevant i produktit mund të përkufizohet si një treg për shërbimet e lizingut.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

25.12.2023

Shkup